

BASHKIA TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” shpk

Adresa: Tiranë, Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë “Tregut 100 Vitinat”, Kulla C, Shkalla 2

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: **Shërbim**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-55770-07-22-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës **Loti 2: “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës CMA Nr.13, në rr.Gjon Buzuku”.**

Loti 2: “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës CMA Nr.13, në rr.Gjon Buzuku”. 2 (muaj) kalendarik.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **23/07/2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : Buletini i Njoftimeve Publike datë 28.07.2025, Nr.39

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☒
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "ALELIER 4" shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k”shpk

NUIS K31812012H & NUIS L81530037K

Vlera e ofertës = **10,118,400** (dhjetë million e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH

Totali i pikëve të marra sipas SPE: **0** pikë

2. Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING ” shpk

NUIS K72113010E

Vlera e ofertës = **8,150,000** (tetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Totali i pikëve të marra sipas SPE: **0** pikë

3. Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” shpk

NUIS L51825011V

Vlera e ofertës = **9,990,800** (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH

Totali i pikëve të marra sipas SPE: 156 pikë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BASHKIMI OPERATORËVE EKONOMIK “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k” shpk .

Bashkimi Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY” shpk nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni 2, pika 2.14.3 të DST sipas kërkesës 2.14.3 **Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**... *“Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.”*

Pas shqyrtimit të plotë dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k”, rezultoi se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k” ka marrë pjesë në 4 lote:

- **Loti 2:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës CMA Nr.13, në rr. Gjon Buzuku”
- **Loti 3:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës EDAL Nr.13, në rr. Gjon Buzuku”
- **Loti 4** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr.59, në rr. 5 Maji”
- **Loti 7:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr. 9, në rr. Hulo Hajderi”

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit për lotet në të cilat ka marrë pjesë Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k”, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni 2, pika 2.14.3, të DST, rezultoi se nuk përmbushet kriteri minimal për stafit e kërkuar, siç përcaktohet qartë në Dokumentet Standarte të Tenderit dhe konkretisht në pikën 6 dhe 7, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Nga shqyrtimi dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k” ka paraqitur dokumentin “Deklaratë e stafit të angazhuar” me të njëjtin staf për secilin lot.

Nga shqyrtimi i kërkesave të kualifikimit “Kapaciteti Teknik” për të gjitha lotet ku ka marrë pjesë, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ATELIER 4” shpk & “HYDRO&ENERGY Sh.p.k” nuk përmbush kërkesat për 3 (tre) Inxhinier Elektrik, 3 (tre) Inxhinier topograf/markshajder/gjeodet dhe 2 (dy) inxhinier gjeolog, çka bie në kundërshtim me pikën 2.14.3, Seksioni 2, “Njoftimi i Kontratës”, **Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit**”, ku është përcaktuar se *“Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.”*

2. OPERATORI EKONOMIK “A & E ENGINEERING” shpk

Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni 2, pika 2.14.3 të DST sipas kërkesës 2.14.3 **Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t’i jepen ofertuesit...** “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.”

Pas shqyrtimit të plotë dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk, rezultoi se Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk” ka marrë pjesë në 7 lote:

- **Loti 1:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr.405, në rr.e Dibrës”
- **Loti 2:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës CMA Nr.13, në rr. Gjon Buzuku”
- **Loti 3:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës EDAL Nr.13, në rr. Gjon Buzuku”
- **Loti 4** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr.59, në rr. 5 Maji”
- **Loti 7:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr. 9, ne rr. Hulo Hajderi”
- **Loti 10:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr. Ish kursanteve (PTT), ne rr. Vangjel Noti”
- **Loti 11:** “Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës Konvikti I ish-shkolles se Partise, ne rr. Dritan Hoxha”

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit për lotet në të cilat ka marrë pjesë Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING”, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni 2, pika 2.14.3, të DST, rezultoi se nuk përmbushet kriteri minimal për stafit e kërkuar, siç përcaktohet qartë në Dokumentet Standarte të Tenderit dhe konkretisht në pikën 6 dhe 7, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Nga shqyrtimi dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” ka paraqitur dokumentin “Deklaratë e stafit të angazhuar” me të njëjtin staf për secilin lot.

Nga shqyrtimi i kërkesave të kualifikimit “Kapaciteti Teknik” për të gjitha lotet ku ka marrë pjesë, Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” nuk përmbush kërkesat për 3 (tre) Arkitekt, 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi (Konstruktor), 3 (tre) Inxhinier Elektrik, 3 (tre) Inxhinier topograf/markshajder/gjeodet dhe 3 (tre) inxhinier gjeolog, çka bie në kundërshtim me pikën 2.14.3, Seksioni 2, “Njoftimi i Kontratës”, **Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t’i jepen ofertuesit**”, ku është përcaktuar se “Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” shpk** me adresë: Tiranë, Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë “Tregut 100 Vitrinat”,Kulla C,Shkalla 2, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9,990,800 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra sipas SPE [156] pikë është identifikuar si ofertues i sukseshëm i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”